



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.73, datë 28.06.2021

PËR
VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË OBJEKTIT
PALLAT 25/1, NR. GIS 23179, RRUGA “HYSEN MYSHKETA” DURRËS

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar, Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin Nr. 97/2019, VKM Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, Raportit mbi vlerësimin e aftësisë mbajtëse strukturore të objektit ekzistues “Godina 25/1 Rajoni 3, Lagja 5, Kodi Gis 23179”, Oponenca e hartuar nga Instituti i Ndërtimit nr.222/6 prot, protokolluar me tonën nr.3094 prot, datë 12.03.2021 “Dërgim përgjigje për Oponencën Teknike të akt ekspertizës së thelluar” dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Vijimin e procedurës të prishjes së detyruar të një objekti banimi, (pallat) 25/1, me nr. GIS 23179, Rruga “Hysen Myshketa” Durrës, ndodhur në Njësinë Administrative nr.3, në zbatim të Raportit mbi vlerësimin e aftësisë mbajtëse strukturore të objektit ekzistues “Godina 25/1 Rajoni 3, Lagja 5, Kodi Gis 23179”, dhe Oponencës së hartuar nga Instituti i

Ndërtimit nr.222/6 prot, protokolluar me tonën nr. 3094 prot, datë 12.03.2021 “Dërgim përgjigje për Oponencën Teknike të akt ekspertizës së thelluar”.

2. Zëvendëskryetari i Bashkisë që kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të ndjekin procedurat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit për leje ndërtimi (prishjen e objektit të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore), sipas parashikimeve të Vendimit Nr.887/2019, të Këshillit të Ministrave.
3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njesisë Administrative nr. 3.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendëskryetari i Bashkisë që kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës, Drejtoria e Kabinetit dhe Njësia Administrative nr. 3.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 461/2 prot.



Durrës, më 06 07. 2021

Lënda: Verifikim i ligshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 73 datë 28.06.2021 Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të objektit pallat 25/1, nr. GIS 23179, rruga "Hysen Myshketa", Durrës.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

